



“SË BASHKU MË TË FORTA”

TETORI ROZË

Muaji i ndërgjegjësimit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit

Së bashku jemi më të forta

» faqe 3

Regjimenti i Këmbëtorisë së Veriut, struktura e re e FA-së



Në kuadër të ndryshimeve strukturore të Forcave të Armatosura, u zhvillua në Vaun e Dejës, ceremonia e krijimit të Regjimentit të Këmbëtorisë së Veriut, pjesë e Forcës Tokësore, si dhe emërimi i komandantit të këtij regjimenti, nënkolonel Ali Mali.

» faqe 2

“Lufta e përjetshme për tokën e shenjtë”



Çdo epokë ka kohën e vet të marrëzisë, sindromë që racën humane e ka shoqëruar qysh në formën e saj primitive, atë të homosapiensit, dhe deri sot në zhvillimin maksimal të kapaciteteve të inteligjencës. Lufta e nisur për mbijetesë dhe e sjellë në ditët tona, si një “grykësi” e pa limit, një oreks që sa vjen dhe shtohet.

» faqe 6

Efektivët e Forcës Tokësore realizuan me sukses qitjen me armë kolektive

Në Poligonin Kombëtar të Bizës, efektivat e gjithë reparteve të Forcës Tokësore realizuan me sukses qitjen me armët kolektive.

Kjo është një qitje e planëzuar në matricën vjetore të stërvitjeve të FT-së për vitin 2023, që kryhet në interes të rritjes së niveleve operacionale në treguesin stërvitje të strukturave të Forcës Tokësore.

Në këtë qitje objektivi kryesor është rritja e kualifikimit të efektivit në qitje me armët kolektive të këmbësorisë, kompaktësimi i veprimeve me qitje reale në fushën e luftimit dhe kolaudimi i armëve të zjarrit.



U ndërthurën dhe u testuan aftësitë e efektivave me armët kolektive, planëzim dhe vlerësimi i situatave luftarake, duke kryer qitje në kushte sa më reale. Në përfundim të qitjes u arritën të gjithë objektivat e përcaktuara në planëzim.



Regjimenti i Këmbësorisë së Veriut, struktura e re e FA-së

Në kuadër të ndryshimeve strukturore të Forcave të Armatosura, u zhvillua në Vaun e Dejës, ceremonia e krijimit të Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut, pjesë e Forcës Tokësore, si dhe emërimi i komandantit të këtij regjimenti, nënkolonel Ali Mali.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, drejtorë drejtorish në SHP, komandantë të reparteve të varësishë të Forcës Tokësore, etj. Në përshëndetjen e tij, gjeneralmajor Arben Kingji, duke e cilësuar krijimin e Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut ditë të shënuar në historinë e kësaj njësie, si një nga strukturat më të reja që i shtohen FARSH-së, e cila do të bëjë të mundur rritjen e mëtejshme të kapaciteteve ushtarake në zonën e veriut të vendit, duke gjeneruar më shumë forca, mjete dhe mbështetje operacionale, u shpreh ndër të tjera: “Në vijim të fazës së implementimit të strukturës së re të Forcave të Armatosura, sot, formësohet një njësi e re e Forcës Tokësore, Regjimenti i Këmbësorisë së Veriut, i cili përbëhet nga tri batalione, i Vaut të Dejës, Kukësit dhe Burrelit. Projektet e modernizimit dhe rikonceptualizimi i përdorimit të forcave në mënyrë sa më efektive dhe të përqendruar në drejtim e organizim, i hapi rrugë ndryshimeve të reja në strukturë. Këto ndryshime strukturore janë produkt i qasjeve të reja të mjedisit rajonal dhe global të sigurisë, i dokumenteve strategjike dhe vendimeve më të fundit të Aleancës për një mbrojtje moderne, që përfshin të gjithë spektrin e operacioneve në kohë paqe, krize dhe lufte...”, - u shpreh gjeneralmajor Kingji. Më tej, gjatë fjalës së tij gjeneralmajor Arben Kingji solli në vëmendje se procesi i transformimit dhe zhvillimit të Forcave të Armatosura do të mundësojë arritjen e niveleve më të larta të operacionalitetit dhe



ndërveprueshmërisë: “Aktualisht janë duke u zhvilluar projekte ambicioze në drejtim të modernizimit të Forcës Tokësore, Detare dhe Ajrore, të cilat do të rrisin ndjeshëm kapacitetet e forcave të luftimit dhe atyre mbështetëse. Jam i bindur se të tre regjimentet e reja të Forcës Tokësore që përmenda më lart, do të jenë një histori suksesi në procesin e transformimit të Forcave tona të Armatosura, për shkak se ngrihen mbi themele të konsoliduara të batalioneve,

tek të cilat kanë spikatur gjithmonë profesionalizmi dhe përkushtimi për përmbushjen me sukses të detyrave...”, - u shpreh gjeneralmajor Arben Kingji. Në përfundim të fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji u shpreh besimplotë se Regjimenti i Këmbësorisë së Veriut do të përmbushë me sukses detyrat e ngarkuara, duke lartësuar dhe më tej emrin dhe arritjet e Batalionit të Parë të Këmbësorisë.

Trupat shqiptare pjesë e “Baltic Warrior”

Trupat shqiptarë në grup-batalionin e NATO-s në Letoni morën pjesë në garën e përvitshme “Baltic Warrior” në Camp Adazi përkrah 200 kolegëve të tyre, duke testuar gjendjen fizike dhe atë psikologjike.

Gara aspak e lehtë përmbante 17 km marshim i ngarkuar me pajime, 1 km transport në krah i mjetit lundrues, 13 km vozitje me kanoe dhe në fund 1 km vrap deri në finish.



"SË BASHKU MË TË FORTA" TETORI ROZË

"Të parandalosh sëmundjen do të thotë të shpëtosh jetë, kjo jetë mund të jetë edhe e jotja"



GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU,
Zëvendëseshëf i Shtabit të Përgjithshëm
të Forcave të Armatosura

Muaji tetor është muaji i ndërgjegjësimit në mbarë botën në luftën ndaj kancerit të gjirit. Kjo sëmundje e rëndë prek këdo nga femrat, mbi moshën 20-vjeçare. Sëmundja nuk bën dallime, ajo mund të prekë këdo nga gratë, por gjithsecila nga ne duhet të ketë njohuri rreth kësaj sëmundjeje. Sot informacioni është i bollshëm, përveçse në qendrat shëndetësore të lagjeve, interneti është mjaft i pasur me informacione të tilla. E rëndësishme është parandalimi i saj, ndërgjegjësimi për të bërë vizita mjekësore. Mendoj se kjo është pika më e dobët në përgjithësi për femrat, të cilat hezitojnë të bëjnë teste, dikush nga padija e rrezikshmërisë së kësaj sëmundjeje, dikush nga frika, më mirë për të mos ta ditur nëse është prekur, por dikush, sidomos në zonat rurale, nuk i ka edhe mundësitë. Në këtë aspekt mendoj se strukturat shtetërore, por edhe private të shëndetësisë, duke filluar nga Ministria e Shëndetësisë deri te qendra e fundit shëndetësore në lagje, apo në fshat, duhet të sensibilizojnë opinionin femëror për rëndësinë që ka parandalimi i kancerit të gjirit. Por edhe mediat kanë rolin e tyre të pazëvendësueshëm, jo vetëm tani që është muaji tetor, që njihet ndërkombëtarisht si muaji i sensibilizimit të luftës ndaj kancerit të gjirit, por gjatë gjithë vitit. Gjithashtu është e domosdoshme që edhe në shkolla të trajtohet ky problem, sidomos në arsimin e mesëm e atë të lartë. Lufta ndaj kësaj sëmundjeje nuk duhet të jetë me periudha por e përditshme. Sa më shumë të parandalojmë nga prekja e kësaj sëmundjeje, aq më shumë kemi ndikuar ndaj shoqërisë, pasi femra është qenia më e domosdoshme për krijimin e një familjeje të shëndoshë dhe ripërtëritjen e jetës në përgjithësi.

Aktualisht, kanceri i gjirit është kanceri më i shpeshtë në popullatën e femrave dhe kanceri i dytë më i përhapur në të gjithë popullatën në Shqipëri, por edhe në botë, prandaj del e nevojshme njohja nga femrat dhe zbatimi i masave parandaluese ndaj kancerit të gjirit, ku do të veçoja: vetëkontrollin e gjirit; ekzaminimin klinik të gjirit nga një personel shëndetësor; bërjen e mamografisë dhe ekos së gjirit 1-2 vjet, të cilat janë disa nga masat dhe hapat që çdo femër duhet t'i dijë dhe t'i ndjekë hap pas hapi.

Po në Forcat e Armatosura si trajtohet ky problem?

Aktualisht në Forcat e Armatosura rreth 15% e personelit ushtarak janë femra ushtarake, ndërsa përfshi edhe personelin civil, kjo shifër shkon në 20%. Nisur nga kjo shifër në rritje të femrave edhe përkujdesja e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm është në rritje, jo vetëm në anën e ecurisë në karrierë, arsimim e kualifikim, por edhe të përkujdesjes ndaj shëndetit të tyre. Me të vërtetë vitet e fundit femrat ushtarake kanë qenë pjesë e shumë projekteve për mbrojtjen e shëndetit të tyre, përfshi edhe bërjen e mamografisë, bërja



e së cilës në disa raste ka parandaluar sëmundjen e rrezikshme të kancerit të gjirit.

Femrat ushtarake, përpara se të jenë ushtarake me të gjitha detyrimet dhe të drejtat si edhe kolegët e tyre meshkuj, janë para së gjithash, nëna, motra, bashkëshorte që nga ana fiziologjike kanë disa veçori. Dhe pikërisht njohja e këtyre

veçorive, duhet të jetë në qendër të punës të komandantëve të çdo niveli për t'i trajtuar femrat ashtu siç u takon, jo duke u krijuar privilegje të pamërituara, por për të zbatuar çdo të drejtë të tyre, përfshi edhe të drejtat në fushën shëndetësore si femra. Njohja e zbatimi Rezolutës 1325 të OKB-së "Gruaja, paqja dhe

siguria", zbërthyer e planifikuar mjaft mirë në Planin e Veprimit Kombëtar dhe në atë të Ministrisë së Mbrojtjes, hartimi i dokumentit për mos lejimin e dhunës e ngacmimeve seksuale në marrëdhëniet e punës, tregojnë e flasin për kujdesin dhe respektin ndaj femrave në përgjithësi dhe atyre ushtarake në veçanti.

Ndërgjegjësimi dhe lufta për parandalimin e sëmundjes së kancerit të gjirit, përveç se detyrim individual i çdo femre, duhet të jetë në qendër të punës të komandave dhe shtabeve në Forcat e Armatosura. Përpara se të jemi ushtarake, me grada e detyra të ndryshme, jemi femra, nëna, motra e bashkëshorte dhe si të tilla veç e veç dhe së bashku si komunitet i femrave ushtarake, meritojmë trajtim dinjitoz në familje, në punë e shoqëri.

Si gjenerale, si zëvendëseshëf i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, por mbi të gjitha si femër, u bëj thirrje të gjitha femrave në Forcat e Armatosura: Kujdesuni për veten, ndërgjegjësoni vetë dhe koleget tuaja, ndërgjegjësoni nënat, motrat dhe vajzat tuaja për rëndësinë që ka ekzaminimi dhe kontrolli periodik, si dhe lufta parandaluese ndaj kancerit të gjirit, e cila nuk duhet të jetë vetëm në muajin tetor, që njihet ndërkombëtarisht si muaji i ndërgjegjësimit ndaj sëmundjes së kancerit të gjirit, por kujdesi dhe lufta duhet të jetë e përditshme, pasi statistikat tregojnë se shifrat rriten përditë.

Të parandalosh sëmundjen e kancerit të gjirit është më e thjeshtë sesa ta kurosh atë. Të parandalosh do të thotë të shpëtosh jetë!



Anija "Butrinti" me mision në detin Egje shpëton 34 emigrantë

Anija "P - 134 Butrinti", pjesë e misionit "Sea Guardian" në detin Egje, gjatë lundrimit konstatoi një gomone me 34 emigrantë, në mes tyre 10 gra dhe 1 fëmijë. Emigrantët ishin nga Jemeni, Sudani dhe Siria.

Anija Butrinti ishte e para në vendngjarje që zbuloi mjetin e paligjshëm dhe më pas komunikoi me Rojën Bregdetare greke dhe turke, të cilat iu përgjigjën thirrjes operacionale.

Roja Bregdetare turke ka marrë në bord mjetin tip gomone dhe personat që ndodheshin në të për të ndjekur procedurat e mëtejshme.



Studentët e vitit të 2 Bachelor, të degës Navigim dhe Komandim detar në fushën e Mbrojtjes, zhvilluan në praktikë kalimin e pengesave ujore në terren konkretisht në liqenin e Çakallës. Kjo i shërben studentëve në familjarizimin e tyre në situata të tilla dhe profesionalizimin në profilet e tyre të përgjithshme ushtarake.



Kursantët e Kursit të Kryekapterit dhe stafit të Shkollës së Nënoficerëve (SHNO) të FSK-së, zhvilluan vizitë në Qendrën Arsimore Profesionale të Nënoficerit të Akademinë e Forcave të Armatosura. Gjatë kësaj vizite pjesëmarrësit u njohën me misionin, detyrat, programet mësimore që zhvillohen respektivisht në dy strukturat; vijuan takime në reparte të Forcës Tokësore dhe përfunduan me vizitën në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu" në Krujë.

Kjo vizitë i shërben rritjes së bashkëpunimit ndërmjet Shkollave përkatëse të Nënoficerëve në fushën e arsimit, trajnimit si dhe shkëmbimit të eksperiencave të ndërsjella.





Ekipi i BMEC-së përfundon kursin bazë dhe të avancuar të kërkim - shpëtimit malor në Kosovë

12 efektivë të BMEC-së në Komandën Mbështetëse morën pjesë në “Kursin bazë dhe të avancuar të kërkim - shpëtimit malor”, në Qendrën Ndërkombëtare të Kërkim - Shpëtimit, në rajonin Pomozotinë, Kosovë.

Qëllimi i këtij kursi ishte përgatitja e personelit për të kryer të gjitha operacionet e kërkimit shpëtimit malor, evakuimit, tejkalimit të pengesave ujore, instalimin e urave me litar, përgatitjen e ankorimeve për lëshimin e ngarkesave. I gjithë trajnimi është konceptuar në përgatitje teorike dhe praktike, ku mbas çdo faze u krye testimi individual i personelit.

Nga ana e personelit pjesëmarrës është treguar një angazhim maksimal në përvetësimin e temave si dhe përgatitje të lartë fizike në përballimin e këtyre operacioneve. Risia e këtyre trajnimeve të tilla të përbashkëta është shkëmbimi i eksperiencave midis dy vendeve dhe ndërveprueshmëria kudo që kërkohet.

Pas përfundimit të kursit bazik dhe të avancuar të kërkim - shpëtimit malor, u certifikua personeli pjesëmarrës.

Në ceremoninë përmbyllëse ishte i pranishëm zëvendësministri i Mbrojtjes i Kosovës Shkëlzen Syla, komandanti i Gardës Kombëtare, gjeneral brigade Naim Naziri, si dhe drejtori QNTKSH-së, z. John Doone.



Zhvillohet stërvitja “Panariti-23”

U zhvillua stërvitja “Panariti-23”, qëllimi i së cilës ishte testimi dhe integrimi i kapaciteteve operacionale të strukturave të Komandës Mbështetëse, Batalionit të Xhenios dhe Batalioni të Furnizimit. Në këtë stërvitje u arrit kompaktësimi i kompanisë së punimeve xheniere si dhe trajnimi i manovratorëve të rinj në përdorim të mjeteve të rënda.

Kjo stërvitje i shërben përmirësimit të infrastrukturës rrugore prej 7 km që lidh fshatrat Panarit - Treskë, në Bashkinë Korçë, i cili i vjen në ndihmë komunitetit të zonës për të mundur lidhjen me shkollat dhe qendrat shëndetësore. Gjithashtu, ky segment rrugor lehtëson detyrën e Forcave të Armatosura për përballimin e Emergjencave Civile.

Forcat xheniere u falënderuan për rezultatin e arritur nga zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, kryetari i Bashkisë Korçë Sotiraq Filo si dhe përfaqësues nga pushteti lokal, prefekti i Korçës, Nertil Jole.





Oprah Winfrey thotë: “Bëj lëvizjen e duhur të radhës, e pastaj lëvizjen e duhur të radhës, sepse ti e di që jeta jote është shumë më e madhe se ai moment”.

Harroje që duhet të arrish atë që të tjerët mendojnë se “duhet” ta arrish.”

Zgjidh të ndjekësh zemrën dhe intuitën tënde, të kuptosh lëvizjen e duhur të radhës do të thotë të lejosh mendjen tënde të forcohet, pa marrë kështu në konsideratë fare se çfarë është “e nevojshme” të bëhet apo të mos bëhet.

Përgatitu për “Momentin që do të vijë”

Pavarësisht asaj që mund të jetë perceptuar si një pengesë në jetë, të gjithë kemi aftësinë të shtyjme përpara dhe të harrojmë paafësitë e të shkuarës.

Ata që besojnë tek fati do të lënë mënjane pengesat e jetës dhe do të ecin përpara. Gjërat që kanë ndodhur në jetën tënde, të mira a të këqija, të kanë përgatitur pikërisht për atë që duhet të jesh, në momentin që je duke përjetuar. “Planifikimi” është një anomalë për këtë mënyrë të menduarit. “Ndërgjegjia” dhe vetëdijesimi janë avantazhe përgatitore; jo strategjia dhe përpikëria.

Harroji Gabimet

Harro çdo gabim që ke bërë ndonjëherë. E ardhmja nuk do të përcaktohet asnjëherë prej të shkuarës. Mos kufizo aftësitë e tua thjesht për shkak të ndonjë gabimi. Të gjithë bëjnë gabime. Është mënyra si zgjedh të reagosh ndaj tyre, që përcakton suksesin apo dështimin.

Mos mbaj mëri, dhe mos hiq dorë nga fuqia jote. Je më mirë se kaq... dhe vetëm ti vendos se çfarë ndodh.

Rreshtoji personalitetin dhe dhuntitë e tua me një qëllim real

E shohim përditë, pavarësisht nëse e kuptojmë ose jo; njerëzit janë fundosur prej trysnisë brenda vetes së tyre, shoqërisë, familjes, me qëllim që të kenë një mënyrë “normale” jetese (për shembull “një vend pune”), për të cilën s’kanë qenë asnjëherë të përshtatshëm.

Gratë e forta kërkojnë respekt, jo vëmendje

Harrojeni këtë lloj marrëzie. Askush nuk do të sjellë ndonjëherë një person me aftësi që janë si të tuat. Fuqizojë veten, ndiq pasionin, harroje “destinimin”, dhe lejoi gjërat të shpalosen si të munden.

Mos shih kufizimet

Sado larg që kemi shkuar si shoqëri, gratë nuk perceptohen po aq “të afta” sa burrat. Mendojeni për një sekondë dhe kuptoni se sa i shpifur është ky fakt: SHBA-ja ka pasur 45 presidentë dhe asnjëra nuk ka qenë grua.

Gratë e suksesshme nuk munden të kufizohen prej çdo lloj “dobësie” apo kufizimi. Ja si e thotë Ursula Burns, një grua afro-amerikane dhe CEO e “Xerox”: “Të gjitha duhet të jemi më të paduruara me status quo-n... duhet ta zhvendosim theksin tek mënyra jonë e të menduarit... nga të menduarit përse uria, varfëria dhe padrejtësia ekzistojnë në botë, tek mënyra si ato mund të eliminohen... Me fjalë të tjera, të gjitha duhet të jemi pak më të paduruara”.

Gratë duhet të jenë këmbëngulëse kur përpichen të arrijnë suksesin. Ato duhet të rrokin shanset që u paraqiten. Nuk është turp për ta bërë këtë gjë... burrat kanë shekuj që e bëjnë.

Qëndro me këmbë në tokë

Të gjithë kemi dhuntitë dhe kufizime, dhe të gjithë kemi aspirata të ndryshme. Madje kemi edhe një farë konfuzioni, për atë se çfarë duhet apo nuk duhet të jenë këto aspirata. Zgjidhja jo dhe aq e thjeshtë, është të mbetesh e vërtetë me vetveten.

Harroji gjithë të tjerët; harroje se si të perceptojnë ata që ke përreth. Kupto çfarë është e

rëndësishme për ty, vazhdo të jesh modeste, dhe mbaj në mendje edhe veten, edhe të tjerët.

Nëse arrin një farë suksesi, mos u mburr. Kupto rëndësinë e përlësisë, një tipar shumë fisnik që mungon në botën e sotme. Më e bukura është që, duke ruajtur këtë lloj sjelljeje, më shumë njerëz do të jenë të gatshëm të ndjekin udhëheqjen tënde.

Ka mijëra shtigje për të qenë një grua e suksesshme, megjithëse ka edhe mure dhe kufizime. Por ka edhe disa rregulla që një grua të arrijë atë që do, suksesin.

Gratë e forta kanë besim në vetvete

Një grua e fortë e di se kush është dhe se çfarë dëshiron. Ajo ka grupin e saj të ëndrrave dhe nuk do të lejojë që dikush ta mbajë peng atë nga arritja e synimeve të saj. Asgjë nuk mund ta ndalë atë!

Ajo nuk ka nevojë për mbështetje nga askush. Ajo gjithashtu nuk ka nevojë të kërkojë miratim nga askush. Gratë e fuqishme marrin vendimet e tyre me vetëbesim dhe nuk kanë frikë të përballen për zgjedhjet e tyre.

Gratë e forta kërkojnë respekt, jo vëmendje

Ju kurrë nuk do të shihni një grua të fortë duke kërkuar vëmendje. Ajo kurrë nuk do të jetë e interesuar të lypë as për dashuri. Kur një grua e fortë ndihet e padëshiruar, ajo thjesht e lë situatën dhe largohet.

Respekti është shumë më i vlefshëm se vëmendja. Ai zgjat më shumë se 15 minuta famë. Respekti është një nga çelësat thelbësorë të suksesit.

Gratë e forta nuk kanë kohë për marrëdhënie toksike, ku ajo bëhet e paarrtshme. Mungesa është dhurata e saj për ata që nuk e kuptojnë se çfarë do

të thotë të jesh në praninë e saj.

Gratë e forta kurrë nuk e krahasojnë veten me të tjerët

Gratë e forta njohin kufijtë dhe aftësitë e tyre. Ato e dinë se janë të denja për respekt. Gratë e fuqishme nuk kanë nevojë ta krahasojnë veten me të tjerët.

Askush nuk është i përsosur dhe një grua e fortë është shumë e vetëdijshme për këtë. Megjithatë, ajo gjithashtu e di se secili ka dhuntinë e vet unike. Ajo pëlqen të mbështesë të tjerët.

Një grua e fortë nuk ka frikë të qajë

Ajo e di se të qenit e lëndueshme është në të vërtetë një shenjë e forcës. Ajo e di se ajo është mjaft e fortë për ta rimarrë veten. Ajo është gati të shërohet.

Një grua e fortë nuk heq dorë kurrë, ajo gjithmonë ka arsye të vazhdojë të luftojë.

Një grua e fortë gjithmonë do t’ju tregojë të vërtetën, pa marrë parasysh sa e vështirë është

Shpesh herë, të thënë të vërtetën mund të jetë një rrezik i madh dhe mund të përfundojë duke dëmtuar dikë. Sidoqoftë, gratë e forta besojnë se të treguarit të vërtetës është thelbësore. Ato e dinë se është një gjë e rrallë.

Gratë e forta janë të guximshme dhe kanë një zemër të mbushur me synime të mira. Ajo shkëlqen si një diamant i pagdhundur!

Nëse e njihni një grua të fortë, mbajeni afër zemrës! Mos kini frikë ta ndani me to këtë artikull dhe t’ia bëni të ditur vlerësimin që keni për të.

Gra të thjeshta me një buzëqeshje të zemrës, janë një burim frymëzimi që të gjithë i admirojnë.

Maratona 2023 sjell fitoren në FA

Zemra e Tiranës u gjallërua nga emocionet dhe adrenalina, teksa u zhvillua edicioni i shtatë i Maratonës së Tiranës. Me një numër marramendës prej afro 5000 pjesëmarrësish që vijnë jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga 47 vende të ndryshme të botës, maratona e këtij viti rezultoi të ishte një festë e atletizmit, vendosmërisë dhe unitetit.

Maratona ofroi kategori të ndryshme, duke përfshirë 10 km, 21 km dhe maratonën e plotë 42 km, duke bashkuar atletë me prejardhje dhe nivele të ndryshme aftësish.

Slogani i maratonës “Vrapojmë për sportin” ishte në përputhje me emërtimin e Tiranës si “Kryeqytet Sportiv” për vitin 2023. Megjithatë, kjo ngjarje nuk kishte të bënte vetëm me konkurrencën, ajo gjithashtu mbrojti kauza të ndryshme. Vrapuesit garuan për ndërgjegjësimin për autizmin, mirëqenien e fëmijëve, dhe jetesës së shëndetshme. Maratona tregoi se si sporti mund të jetë një forcë bashkuese, duke kapërcyer kufijtë dhe gjuhët.

Maratona e Tiranës e këtij viti dëshmoi një debutim historik mes vrapuesve kenianë që performanca dhe vendosmëria e tyre e jashtëzakonshme shkëlqeu teksa fituan tre çmimet kryesore në kategori të ndryshme, duke lënë një përshtypje të qëndrueshme në komunitetin e vrapimit të Tiranës.

Ndër arritjet e spikatura, kolonele honorifike Luiza Gega, sportistja e njohur shqiptare, kryesoi kategorinë e femrave në garën 21 km, duke përfunduar me një kohë të jashtëzakonshme prej 1 orë e 13 minuta. Fitorja e saj u prit me brohoritje dhe admirim, duke dëshmuar se talenti vendas vazhdon të shkëlqejë fuqishëm në skenën



ndërkombëtare, major Bledar Mesi, i cili zuri vendin e dytë në garën 10 km, si dhe një personel prej 300 efektivash të Forcave të Armatosura.

Maratona e Tiranës vazhdon të rritet në shtat

dhe tërheqje ndërkombëtare, duke bashkuar vrapues me prejardhje të ndryshme për të festuar frymën e sportit dhe solidaritetit. Suksesi i ngjarjes është një dëshmi e fuqisë së qëndrueshme të sportit për

të bashkuar njerëzit dhe për të mbështetur kauza të ndryshme sociale, duke e bërë atë shumë më tepër se një garë; është një simbol i frymëzimit dhe bashkimit.



Në kuadër të Kampionatit Kombëtar të Sporteve Universitare, u zhvillua ceremonia e hapjes së këtij aktiviteti të rëndësishëm sportiv.

Akademia e Forcave të Armatosura mori pjesë në këtë aktivitet me 3 ekipe përfaqësuese: futboll për meshkuj, basketboll për meshkuj dhe volejball për femra.

Ekipe sportive të AFA-së kanë treguar shpirt gare dhe përfaqësim dinjitoz.

Nis Kampionati Kombëtar i Sporteve Universitare





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Çdo epokë ka kohën e vet të marrëzisë, sindromë që racën humane e ka shoqëruar qysh në formën e saj primitive, atë të homosapiensit, dhe deri sot në zhvillimin maksimal të kapaciteteve të inteligjencës. Lufta e nisur për mbijetesë dhe e sjellë në ditët tona, si një “grykësi” e pa limit, një oreks që sa vjen dhe shtohet.

11 nëntori 1918, solli fundin e shumëdëshiruar të luftës së parë botërore. Por ai nuk solli fundin e dhimbjes. Privimet, varfëria dhe hidhërimi u zënë frymën njerëzve. Këtyre u shtohet edhe një ndjenjë si ajo që ishte luftuar më kot dhe e gjithë vuajtja ishte më kot. Por e gjitha kjo u kthye në mllef, i cili me një ndjenjë helmuese e kthyer në terrenin ushqyes të ngjitjes politike të një ish-ushtari në front me emrin Adolf Hitler, çizmja e të cilit shkeli cep e më cep botën, për të marrë jetën e mijëra e mijëra njerëzve të pafajshëm.

Por ç’na ofron sot arena politike në këtë botë të induktuar nga dëshira për të gllabëruar atë që nuk ju takon. Dhe ‘marrëzia’ vazhdon në Europën e plakur luftërash mes Ukrainës dhe barbarizmave ruse, për të vazhduar me luftimet midis Izraelit dhe Hamasit, që nisi një sulm të papritur, më 7 tetor, janë më



të rejat në shtatë dekada luftë dhe konflikt midis izraelitëve dhe palestinezëve që kanë tërhequr vëmendjen e fuqive të jashtme dhe kanë destabilizuar rajonin më të gjerë të Lindjes së Mesme.

Njeriu, një qenie komplekse. Një qenie, e cila s’di të ndalet përpara vështirësive që i hasen rrugës së përmbushjes së synimeve të tij. Por shpesh herë, rruga që ndjekin këto synime është katastrofike. Dëshira e njeriut të pangopur për territore e pasuri natyrore, ka çuar në zhvillimin e luftërave. Kjo i ka fillesat qindra, e ndoshta mijëra vjet më parë.

Njerëzit ndër shekuj kanë luftuar ndërmjet tyre. E quanim veten, qenia më e zhvilluar në planet. Por ku shihet zhvillimi kur ti lufton kundër sojit tënd? Kur ti ke guximin të vrasësh një qenie pa asnjë ndryshim nga ty, a nuk mendon se po vret një pjesë të njerëzimit? Ndoshta edhe një gjeneratë të ardhshme që mund të sjellë ndryshimin në këtë botë. Por lakmia e dëshira për pushtet duket se ka pushtuar shpirtin e shumë prej nesh. E kur shohim dëmet katastrofike, të bëra me vetëdije, shpesh herë na shfaqet paqja. Duket se ajo është një mirazh në shkretëtirë, në aktualitetin e sotëm.

Vetë historia e botës është krijuar nga luftërat e mëdha, i lexojmë nëpër libra dhe poezi i shohim nëpër piktura. Piktura që ngjallin vuajtje, dëshpërim, ndjenja të përhubura në një kohë ku e vetmja zgjidhje për jetën ishte të ngrije një armë dhe të luftoje. Nëse Tolstoi do të ishte mes nesh do të thoshte: “Miku im, luftëtari më i fuqishëm zotëron dy armë, durimin dhe kohën”.

“Lufta e përjetshme për tokën e shenjtë”



Nëse do ishte kështu, luftërat do të flisnin me gjuhën e mendjes dhe diplomacia do ishte zgjidhja e konfliktit.

Kujtimet tmerruese të dhembin më shumë sesa një plagë në trup

Lufta shihet si një “oqean i kuq”, ku mbi të flluskojnë armë dhe trupa të pajetë. Kjo “lojë”, e cila po merr jetë njerëzish të pafajshëm, nuk po ndalet në të gjithë botën.

Data e nisjes së ofensivës palestineze nuk është rastësore, pasi përkon me luftën e Yom Kipurit, e njohur gjithashtu si Lufta e Ramazanit, e Tetorit, Lufta e katërt Arabo-Izraelite, që ishte një konflikt i armatosur i zhvilluar nga 6 deri më 25 tetor 1973 midis Izraelit dhe një koalicioni shtetesh arabe, të udhëhequra nga Egjipti dhe Siria. Pjesa më e madhe e luftimeve midis dy palëve u zhvillua në Gadishullin Sinai dhe Lartësitë e Golanit, të dyja të pushtuara nga Izraeli më 1967. Objektivi fillestar i Egjiptit në luftë ishte të kapte një terren në bregun lindor të Kanalit të Suezit dhe më pas të përdorte këto përfitime për të negociuar kthimin e pjesës tjetër të Gadishullit Sinai të pushtuar nga Izraeli

Për të udhëtuar edhe më tej në lashtësi, zanafilla buron nga pretendimi se cili popull është autokton apo më i lashti në tokën e shenjtë.

Hebrenjtë pretendojnë se ata thjesht po kthehen në rrënjët e tyre, duke e zbrëthyer orën në kohët e Dhiatës së Vjetër. Madje izraelitët pretendojnë se kanë jetuar në atë territor të paktën 3700 vjet më parë, ndërsa janë detyruar të zhvendosen në vitin 70 pas Krishtit, sepse Romakët shkatërruan tempullin e dytë të tyre në Jeruzalem. Gjithashtu izraelitët besojnë se termi “Palestinë” besohet se rrjedh nga filistinët, një popull i Egjeut, i cili, në shekullin e 12-të para Krishtit u vendos përgjatë fushës bregdetare të Mesdheut të asaj që tani është Izraeli dhe Rripi i Gazës.

E vërteta për Palestinezët është plotësisht ndryshe.

Ata pretendojnë se kanë qenë aty që nga fillesat e njerëzimit dhe më pas janë përzierë më të gjitha formacionet e emigrimeve përgjatë shekujve, nga Mesdheu e deri të vendet arabe. Duke iu referuar po të njëjtit libër të shenjtë në të cilin besojnë vetë hebrenjtë, palestinezët besojnë se ky popull i përket një grupi skllëvërishtë të dëbuar nga Egjipti i periudhës faraonike.

Dhe sa e vërteta të gjejë rrugën e saj, nënat do vazhdojnë të klithin vajtueshëm për humbjen e jetëve të fëmijëve të tyre. Gjithçka e ndërtuar me mund dhe sakrificë do të kthehet në shtëllunga të mëdha tymi. Dhe për brezat do të jetë: “Dhe historia vazhdon....”.





Skënderbegasi Veli Rada, një jetë mes artit dhe sportit

Veli Rada u lind në Tiranë, më 23 shkurt 1942. Po në Tiranë, kreu me rezultate të mira dhe arsimin 7-vjeçar. Në vitin 1958, Veli Rada nis studimet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” dhe e përfundon me rezultate të mira në vitin 1962. Në shtator të këtij viti, nis studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha” në Tiranë, në specialitetin këmbësori. E përfundon këtë shkollë në vitin 1965 dhe titullohet oficer karriere në specialitetin këmbësori. Tashmë, me uniformën e oficerit, Veli Rada nis karrierën e tij ushtarake në njësitë e Tiranës. Emërohet në Brigadën e Parë Sulmuese (në lagjen Kombinat), ku kryen detyra në funksionet bazë të këtij reparti. Ndërkohë, Veli Rada, përveçse profesionin e oficerit, kishte një talent dhe pasion dhe për artin, interpretimin si dhe dashurinë për sportin, veçanërisht komentimin e lojës së futbollit. Falë këtyre cilësive, ai është pjesëmarrës aktiv në shumë aktivitete, estrada që organizoheshin nëpër reparte e njësi të ushtrisë, duke u pëlqyer nga shikuesi. Më pas, Rada angazhohet në estradën e ushtrisë, ku dallohet si aktor, sidomos në fushën e humorit. Janë shumë role të luajtura nga ai në këtë periudhë e më pas, që janë pëlqyer nga spektatorët dhe mbijetuan gjatë... Më pas, karriera e Veli Radës në Forcat e Armatosura do të ndërpritej, e ai do i përkushtohet profesionit të bukur të aktorit dhe të komentatorit sportiv në radio.

Më pas, Veli Radës i jepet e drejta që të ndjekë studimet në Akademinë e Arteve, të cilën e mbaron në vitin 1974. Në vitin 1983, filloi punë si aktor në Estradën e Tiranës, ku punoi për plot 35 vjet. Ka luajtur shumë role në estradë, edhe pse ai u diplomua për dramë.

Komeditë, skeçet, monologët, kupletet dhe disa zhanre të tjera të humorit ishin dhe do të mbeten pjesa më e madhe e krijimtarisë së tij. Por jeta aktive e Veli Radës nuk mund të kuptohet pa mikrofonin. Si gazetar sportiv, ai ka transmetuar në radio e televizione qindra ndeshje kombëtare e ndërkombëtare, duke qenë i veçantë në komunikimin me artdashësit dhe mënyrën e përcjelljes së emocioneve tek ata. Njëkohësisht, ai ka qenë shumë aktiv dhe në median e shkruar.

Në aktrimin e tij spikat prirja për të realizuar karaktere personazhesh me natyrë disi nervoze, njerëz prepotentë, drejtues e administratore burokratë, politikanë ekstremistë etj. Përdori gjeste të prera e me të folur “të ashpër”, duke shfrytëzuar me sens komik, po aq, edhe zhargonet e të folurit, sidomos zhargonin e rëndë të labërishtes, atë të minoritetit grek etj. Pas roleve të vogla në gjinitë e estradës, ka luajtur edhe në komeditë “Tre dhëndurët”, “Lezeti i kolltukut dhe krevatit”.

Në komedinë dhe filmin humoristik “Revolja e humbur”



(1995) luajti rolin e hetuesit, me të cilin krijoi figurën e dhunshme e dinake të nëpunësit të sigurimit të shtetit në periudhën e diktaturës. Rolet e karakterit i kishte të parat.

Përveç varieteve, në shfaqjet ku interpretoi kanë lënë gjurmë, “Tre dhëndurët” e Dionis Bubanit, me regji të Piro Manit e realizuar në vitin 1985.

“Tela për violinë”, “Kur hapen dyert e jetës”, “Ilegalët”, “Fundi i një gjakmarrjeje” si dhe tek telekomedia “Mirela”.

Veli Rada ka qenë golashënuesi më i mirë i spartakiadës së Ushtrisë. Në periudhën 1995-1997 u angazhua me grupin artistik të ushtrisë që e krijoi vetë. Për dy vite punoi si komentator sportiv në televizion.

Në vitin 2009 filloi punë në Qendrën Kulturore Artistike të Ushtrisë. Më 28 shkurt të vitit 2013, Presidenti i Republikës Bujar Nishani i akordoi Urdhrin “Mjeshtër i Madh”. Ndërroi jetë më 27 dhjetor të vitit 2014, në moshën 72-vjeçare.





Si po ndryshon botën teknologjia dhe si duhet ta ndryshojë bota teknologjinë?

Makinat, aeroplanët, pajisjet mjekësore, transaksionet financiare dhe sistemet e energjisë elektrike mbështeten të gjitha në më shumë softuerë kompjuterikë se sa ndonjëherë më parë, duke i bërë ato të duken më të vështira për t'u kuptuar dhe, në disa raste, më të vështira për t'u kontrolluar. Mbikëqyrja e individëve dhe e korporatave dhe përpunimi i informacionit mbështetet kryesisht në teknologjitë dixhitale dhe inteligjencën artificiale, dhe për këtë arsye përfshin më pak kontakte njeri me njeri se kurrë më parë dhe më shumë mundësi për paragjykimet për t'u ngulitur dhe kodifikuar në sistemet tona teknologjike në mënyra që ne nuk mund të jemi në gjendje të identifikojmë ose njohim.

Përparimet e bioinxhinierisë po hapin terren të ri për pyetjet sfiduese filozofike, politike dhe ekonomike në lidhje me marrëdhëniet njerëzore-natyrore. Për më tepër, menaxhimi i këtyre pajisjeve dhe sistemeve të mëdha dhe të vogla bëhet gjithnjë e më shumë përmes resë kompjuterike, në mënyrë që kontrolli mbi to të jetë shumë i largët dhe i hequr nga kontrolli i drejtpërdrejtë njerëzor ose shoqëror. Studimi se si t'i bëjmë teknologjitë si inteligjenca artificiale ose Interneti i Gjërave të "shpjegueshme" është bërë fusha e tij e kërkimit sepse është kaq e vështirë të kuptosh se si funksionojnë ato ose ku qëndron problemi kur diçka shkon keq (Gunning dhe Aha 2019).

Ky kompleksitet në rritje e bën më të vështirë se kurrë, dhe më të domosdoshme se kurrë, që studiuesit të hetojnë se si përparimet teknologjike po ndryshojnë jetën në mbarë botën në mënyra pozitive dhe negative dhe cilat mjete sociale, politike dhe ligjore nevojiten për të ndihmuar në formimin e zhvillimin dhe projektimin e teknologjisë në drejtime të dobishme. Kjo mund të duket si një detyrë e pamundur në dritën e ritmit të shpejtë të ndryshimit teknologjik dhe ndjenjës se përparimi i vazhdueshëm i tij është i pashmangshëm, por shumë vende në mbarë botën

sapo kanë filluar të ndërmarrin hapa të rëndësishëm drejt rregullimit të teknologjive kompjuterike dhe janë ende në proces të rimendimit rrethësor të rregullave që rregullojnë flukset globale të të dhënave dhe shkëmbimin e teknologjisë përtej kufijve.

Këto janë kohë emocionuese jo vetëm për zhvillimin teknologjik, por edhe për politikën e teknologjisë. Teknologjitë tona mund të jenë më të avancuara dhe më të ndërlikuara se kurrë, por po ashtu janë edhe kuptimet tona se si ato mund të shfrytëzohen, mbrohen dhe madje të kufizohen më së miri. Strukturat e sistemeve teknologjike të përcaktuara kryesisht nga politikat qeveritare dhe institucionale dhe ato struktura kanë implikime të jashtëzakonshme për organizimin dhe agjencinë shoqërore, duke filluar nga sistemet me burim të hapur, sistemet e hapura që janë shumë të shpërndara dhe të decentralizuara, deri te ato që kontrollohen fort dhe të mbyllura, të strukturuar sipas modeleve më të rrepta dhe më hierarkike.

Premtimet dhe kurthet e teknologjisë

Teknologjia mund të jetë një burim i një optimizmi të jashtëzakonshëm. Mund të ndihmojë në kapërcimin e disa prej sfidave më të mëdha me të cilat përballet shoqëria jonë, duke përfshirë ndryshimin e klimës, urinë dhe sëmundjet. Për ata

që besojnë në fuqinë e inovacionit dhe premtimin e shkatërrimit krijues për të çuar përpara zhvillimin ekonomik dhe për të çuar në cilësi më të mirë të jetës, teknologjia është një shtytës jetik ekonomik (Schumpeter 1942).

Por mund të jetë gjithashtu një mjet frike dhe shtypjeje të jashtëzakonshme, duke ngulitur paragjykime në proceset e automatizuara të vendimmarrjes dhe në algoritmet e përpunimit të informacionit, duke përkeqësuar pabarazitë ekonomike dhe sociale brenda dhe midis vendeve në një shkallë marramendëse, ose duke krijuar armë dhe rrugë të reja për sulm ndryshe nga çdo gjë me të cilën është dashur të përballemi në të kaluarën. Studiuesit madje kanë pohuar se shfaqja e termit teknologji në shekujt e nëntëmbëdhjetë dhe njëzetë shënoi një zhvendosje nga shikimi i pjesëve individuale të makinerive si një mjet për të arritur përparim politik dhe shoqëror në pikëpamjen më të rrezikshme ose në shkallë më të gjerë. Sistemet komplekse teknologjike ishin një formë gjysmë-autonome e përparimit në vetvete.

Kohët e fundit, teknologët kanë kritikuar ashpër atë që ata e shohin si një valë Ludditësh të rinj, njerëz që synojnë të ngadalësojnë zhvillimin e teknologjisë dhe të kthejnë kohën pas inovacionit si një mjet për të zbutur ndikimet shoqërore të ndryshimeve teknologjike (Marlowe 1970).

Në zemër të grindjeve për teknologjitë e reja dhe ndryshimet globale që rezultojnë nga ato janë shpesh dy vizione kontradiktore të teknologjisë: një vizion thelbësisht optimist që beson se njerëzit e përdorin atë si një mjet për të arritur qëllime më të mëdha dhe një thelbësisht pesimist që mendon se sistemet teknologjike kanë arritur në një pikë përtej kontrollit tonë. Filozofët e teknologjisë kanë argumentuar se asnjëra nga këto pikëpamje nuk është plotësisht e saktë dhe se një pikëpamje thjesht optimiste ose pesimiste e teknologjisë është e pamjaftueshme për të kapur nuancat dhe kompleksitetin e marrëdhënies sonë me teknologjinë (Oberdiek dhe Tiles 1995).

Të kuptuarit e teknologjisë dhe se si mund të marrim vendime më të mira për projektimin, vendosjen dhe përsosjen e saj kërkon kapjen e asaj nuance dhe kompleksiteti përmes analizës së thellë të ndikimeve të përparimeve të ndryshme teknologjike dhe mënyrave se si ato kanë luajtur në të gjithë rrëmujën e tyre të ndërlikuar dhe të diskutueshme në të gjithë botën.

Këto ndikime janë shpesh të paparashikueshme, pasi teknologjitë adoptohen në kontekste të reja dhe përdoren në mënyra që ndonjëherë ndryshojnë ndjeshëm nga rastet e përdorimit të parashikuara nga projektuesit e tyre. Interneti, i krijuar për të ndihmuar në transmetimin e informacionit midis

